



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 868/1 Prot.

Tiranë, më 28/06 / 2018

Lënda: Dërgohen rekomandime mbi projekt-vendimet në zbatim të Ligjit “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare”.

Drejtuar: ZNJ. LINDITA NIKOLLA
MINISTËR
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

TIRANË

E nderuar znj. Nikolla,

Në përgjigje të shkresës Tuaj nr. 6459, datë 13.06.2018, me lëndë “Dërgohen projekt-vendime”, me anë të së cilës është kërkuar adresimi i komenteve të Komisionerit me qëllim përmirësimin e projekt-vendimeve të hartuara në zbatim të Ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, po ju paraqesim rekomandimet tona për çdo projekt-vendim si më poshtë vijon¹:

- Projekt-vendimi “Për masat e përshtatshme për nxitjen e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë”, mbështetet në nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 13, pika 4, të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Ky akt ka për qëllim përfshirjen e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare, në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë.

¹ Këto rekomandime i janë përciell edhe Ministrisë për Europen dhe Punëve të Jashtme, në kuadër të qenies anëtar të grupit të punës “Për hartimin e akteve nenligjore për Ligjin “Për Pakicat Kombëtare”.

Në këtë projekt-vendim propozojmë të shtohet një pikë me përmbajtjen si më poshtë, mbas pikës 3:

“Kriteret për përfitimin e mbështetjes së plotë ose të pjesëshme financiare, duhen vendosur duke mbajtur parasysh parimin e barazisë dhe mosdriskriminimit për pakicat kombëtare të konsideruara vulnerabël”.

- Projektvendimi “Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimit të klasave mësimore në gjuhën e pakicave kombëtare”. Ky akt nënligjor është hartuar në kuadrin e plotësimit të paketës nënligjore në zbatim dhe bazuar në ligjin nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në këtë projektvendim, propozojmë të shtohet në vijim të pikës 3 parashikimi i mëposhtëm:

Nisma për hapjen e klasave me nxënës të pakicave kombëtare mund të merren nga:

d. “Kërkesa e prindërve ose e kujdestarëve ligjore”

Gjithashtu në projekt-vendim të shtohet mbas pikës 5 një pikë me përmbajtje:

“ E drejta për arsim në gjuhën e pakicës nuk duhet të çënojë mësimin e gjuhës shqipe.”

- Projektvendimi “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrin thelbësor dhe kërkesën e mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare, për t’u mësuar në gjuhën e pakicës”, është hartuar në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe synon përcaktimin e kriterëve për përcaktimin e njësive vendore, numrin thelbësor për t’u arsimuar në gjuhën e pakicave.

Në këtë projektvendim, mendojmë të shtohet edhe një kriter për hapjen e klasave me nxënës të pakicave, si më poshtë: Në vijim të pikës 3:

1. Nisma për hapjen e klasave me nxënës të pakicave kombëtare mund të merret edhe nga:

“Komuniteti i zonës, ku pritet të hapen klasa me nxënës të pakicave kombëtare”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

